RrGGK dhe Alter Habitus Publikojnë Raportin "Ku janë paratë për të drejtat e grave?"

Prishtinë (e hënë, 18 nëntor 2013) – Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) dhe Alter Habitus – Instituti për Studime në Shoqëri dhe Kulturë, publikuan raportin "Ku janë paratë për të drejtat e grave?".

Kjo ngjarje bashkoi më shumë se dyzet pjesëmarrës (donatorë, organizatat jo qeveritare të grave dhe pjesëtar tjerë të shoqërisë civile) për të diskutuar të gjeturat dhe rekomandimet e hulumtimit 9 mujor.

Në prezantimin e saj, Nicole Farnsworth, Hulumtuese Kryesore në Rrjetin e Grupeve të Grave të Kosovës, theksoi se "organizatat për të drejtat e grave luajnë rol të rëndësishëm në përkrahjen dhe krijimin e institucioneve demokratike, avancimin e të drejtave të grave si të drejta të njeriut, ndryshimin e normave gjinore, ngritjen e vetëdijes publike, ofrimin e shërbimeve për grupet të margjinalizuara (veçanërisht kur mungon përkrahja nga shteti), dhe kërkimin e llogaridhënies nga qeveria përmes avokimit".

Në mënyrë specifike, hulumtimi ekzaminoi: rëndësinë që ka mbështetja e organizatave të grave në proceset e ndryshimeve shoqërore; ndryshimet historike në trendët e financimit mes viteve 2000 dhe 2013; qëndrueshmëria financiare e organizatave të grave; trendët që ndikojnë në vendimet e donatorëve për financimin (ose mos financimin) e organizatave të grave, dhe mundësitë e bashkëpunimit mes organizatave të grave dhe donatorëve në krijimin e strategjive të përbashkëta për mobilizimin e resurseve dhe mekanizmave të financimit për organizatat e grave. Raporti gjithashtu sjell rekomandime për të gjitha grupet e interesit: për qeverinë, organizatat jo qeveritare të grave dhe donatorët, në atë se cilat do të ishin mënyrat më të mira për të sjell rezultate të frytshme në fushën e avancimit të barazisë gjinore në Kosovë, si dhe krijimin e një strategjie gjithëpërfshirëse për mobilizimin e resurseve nga perspektiva e lëvizjes feministe.

Ishte pajtim unanim nga të gjithë pjesëmarrësit se një koordinim më i mirë mes donatorëve, organizatave të grave, dhe qeverisë do të ndihmonte në avancimin e të drejtave të grave. Për më tepër, Fondi i Grave të Kosovës brenda Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës, i cili kombinon grante të vogla me trajnim intensiv dhe mentorim për organizata, u pa si zgjidhje potenciale për donatorët të cilët dëshirojnë të përkrahin organizatat e vogla, të cilat nuk kanë kapacitetin për të konkurruar me organizatat e mëdha, mirëpo, që bëjnë punë shumë të rëndësishme me grupet rurale dhe të margjinalizuara.

Gjithashtu, ishte kërkesë nga organizatat e grave për kontrata afatgjate me donatorët, sepse kjo do të iu mundësojë organizatave për të zbatuar strategji drejt një vizioni afat gjatë. Për to, përkrahja afat-gjate qartazi e ndikon në forcimin e lëvizjes së grave në Kosovë dhe avancimin e ndryshimeve shoqërore.

"Ku janë paratë për të drejtat e grave?", mbështetur nga Association of Women in Development dhe Kvinna till Kvinna, është zhvilluar në mes muajit janar dhe shtator 2013, dhe përfshinë 40 intervista me donatorët të cilët janë në Kosovë, dhe pyetësor me 90 organizata të grave.

Për më shumë informata mbi raportin dhe të gjeturat ju lutem vizitoni faqen e Rrjetit të Grupeve të Grave: http://www.womensnetwork.org/documents/20131120160749318.pdf.